



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 573/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Nehat Idrizi kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik i Gazetaris Hulimtuese (BIRN), paraqitur kundër Agron Prenaj (AAK), për shkak të kërcënimit dhe parregullsive gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulimtuese (BIRN).

## A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga BIRN-i, ne te cilën pretendohet se me datë 12.12.2010, në QV 0219c ne vendvotimin 04D fshatin Novoselë komuna e Gjakovës ne ora 17:55 vëzhguesi i AAK-ës Agron Prenaj është parandaluar te votoj për here te dyte nga disa vëzhgues te tjerë. Agron Prenaj ne fjalosje e siper nxjerr nga xhaketa e tije nje arme te ftohte (konkretisht thike) me dorez te kaltert dhe bërtiste se nuk kam votuar.Me pastaj kercenoi se do ta priste shiritin e kutise se votimit por nuk e beri.Ai u largua nga vendvotimi por u kthye pas nje kohe te shkurter dhe vazhdoi vëzhgimin.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë, përveç se përmend Muharrem Musliun kryesues i venvdvolimit, si dhe Petrit Qollakun në cilësinë e dëshmitarit.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

- **ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës janë të pabazuara për shkakun se nuk është ofruar asnjë dëshmi apo prova të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur shkelja e pretenduar nga i lartpermenduri. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 573/2010 më datën 16.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit  
Nehat Idrizi**

